

SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Zyrtar i Ri i Licencimit
Departamenti: Licencim dhe Standardizim
Divizioni: Licencimit
Niveli i gradës: 7
Raporton tek: Udhëheqësit të Divizionit të Licencimit/Drejtorit të DLS-së

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

1. Zbaton Manualët dhe Procedurat e Licencimit dhe të gjitha rregullat e brendshme të Departamentit;
2. Kontribuon në shqyrtimin, vlerësimin dhe analizimin e të gjitha aplikacioneve për licencim, në pajtim me kornizën ligjore në fuqi;
3. Shqyrton, vlerëson dhe analizon, në rastet më të komplekse në bashkëpunim me Udhëheqësin e Divizionit të Licencimit apo Drejtorin e DLS-së, të gjitha kërkesat e të institucioneve financiare, të cilat i delegohen, në pajtim me kornizën ligjore në fuqi;
4. Kontribuon në analizimin e raporteve biografike dhe financiare të aksionarëve, drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë të institucioneve financiare;
5. Përgatitë rekomandimet për aprovime/refuzime/revokime të kërkesave të deleguara drejtuar Udhëheqësit të Divizionit të Licencimit, Drejtorit të DLS-së dhe Bordit Ekzekutiv;
6. Shqyrton të gjitha kërkesat për hapje, zhvendosje dhe mbyllje të degëve dhe zyrave të institucioneve financiare;
7. Kontribuon në shqyrtimin e të gjitha kërkesave për licencim/regjistrim të agentëve/brokerave të institucioneve financiare;
8. Kryen ekzaminimet e para hapjes në degët/zyrat e institucioneve financiare;
9. Mirëmban dosjet fizike dhe elektronike të institucioneve financiare duke përfshirë regjistrat për personat kyq (aksionarët, drejtorët dhe menaxherët e lartë), zyrat e institucioneve financiare, agentët dhe brokerat e institucioneve financiare;
10. Kontribuon në draftimin e politikave, procedurave, manualeve të licencimit, rregulloreve, rregullave dhe udhëzimeve tjera të institucioneve financiare, të deleguara;
11. Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante të Departamentit;
12. Kryen të gjitha detyrat tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizioni i Licencimit dhe Drejtori i DLS-së.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

1. Diplomë bachelor në ekonomi, financa, kontabilitet;
2. Rrjedhshmëri në gjuhën shqipe dhe/ose serbe;
3. Njohje e gjuhës angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
2. Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
3. Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
4. Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

1. Afati i fundit për aplikim është **03 shkurt 2022**.
2. Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
3. Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
4. **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**